

REPUBLICA KOSOVO-REPUBLIKA E KOSOVËS
OPŠTINA ŠTRPCE-KOMUNA E SHTËRPCËS

01/Br.Prot. IZLAZNI - DALËSE
Nr.Prot. 01 - 020/08-2512/18
Br.str.
Nr.i fq. 1
Datum 28.02.2018
Data
ŠTRPCE - SHTËRPCË



Republika Kosova-Republika e Kosovës-Republic of Kosovo

Opština štrpce

Komuna e Shtërpcës

Municipality of Štrpce



Në mbështetje të nenit 12, 17, 40 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, të neneve 10 dhe 34 të Statutit të Komunës së Shtërpcës Nr. 01- 898 të datës 14/07/2010, Kuvendi i Komunës së Shtërpcës në mbledhjen e mbajtur më datën 26/02/2018 miratoi këtë :

V E N D I M

Miraton procesverbal nga seanca e kuvendit e mbajtur me 29.01.2018

1. Miratohet procesverbal nga seanca e kaluar e Kuvendit i Komunës sipas tekstit e dhënë në këtë vendim.
2. Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e Kryesuesit të Kuvendit Komunal .

Kryesuesi i Kuvendit

Predrag Grbic





REPUBLIKA KOSOVO-REPUBLIKA E KOSOVËS	
OPŠTINA ŠTRPCE-KOMUNA E SHTËRPCËS	
IZLAZNI - DALËSE	
01/Br.Prot.	01-020/08-2512/18
Nr.Prot.	
Br.str.	9
Nr.i fq.	
Datum	28.02.2018
Data	
ŠTRPCE - SHTËRPCË	



Republika Kosova-Republika e Kosovës-Republic of Kosovo
Skupstina opštine štrpce
Kuvendi i Komunës së Shtërpçës
Municipality of Strpce

PROCESVERBAL

Nga seanca e dytë rregullt e KK-ës të mbajtur më 27.06.2017, me fillim në ora 10:00 h.

Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i rendit të ditës
2. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga seanca e kaluar e KK Shtërpçë
3. Zgjedhja e zëvendësit të kryetarit për komunitete
4. Formimi i komitetit për politik dhe financa
5. Formimi i komitetit për komunitete
6. Formimi i komisionit për hartimin e planit të punës së Kuvendit
7. Propozim i vendimit për hartimin e planit zhvillimor e komunës
8. Të ndryshme

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i rendit të ditës

Predrag Grbic: Të nderuari kryetar i komunës, zëvendësit e kryetarit, i nderuari këshilltar, drejtorët e drejtorisë, përfaqësuesit e OSEB-ës, dhe të gjithë të tjerë të pranishëm, mirëdita dhe mirë se erdhët në kuvendin e dytë. Në kuvendin e sotshëm marrin pjesë të gjithë 15 anëtarë, që do të thotë se kemi kuorumin dhe mundemi të fillojmë me punë. A lajmërohet dikush për fjalë për rendin të ditës? Pasi nuk lajmërohet askush, qes në votim këtë pik. Do të kisha tërhequr vëmendjen këshilltarëve, në ato që do t'i kushtoj vëmendjen të veçantë gjatë periudhës së ardhshme katërvjeçare. Do të isha përqendruar te Neni 12. Lidhur me Rregulloren e Punës, e cila i referohet punës gjatë Kuvendit. Ajo përshkruan qartë, se sa shpesh këshilltari mund të lajmërohet për fjalë, sa kohë mund të jetë ekspozimi i tij dhe ka drejt për replikë. Kjo u shkrua me qëllimin që Kuvendi të zgjat një kohë normale. E drejta e këshilltarëve për të diskutuar, kur lajmërohen për fjalë është 5 minuta, pastaj ka të drejtë për replikë, por nëse dikush e kishte thirrur me emër dhe mbiemër, ose në qoftë se dikush është thirrur në diskutimin e tij. Unë mund të jepi dikujt fjalën dhe tretin here, në qoftë se vlerësimi im është se diskutimi i atij këshilltarit e Kuvendit, zhvillohet në një drejtim pozitiv. Replika zgjat 2 minuta, madje edhe kur bëhet fjalë për rendin e ditës, këshilltari mund të diskutojë të njëjtën 2 minuta. Ju lutemi të kujdeseni për këtë, dhe në këtë mënyrë do ta respektoni veten dhe këtë institucion, në të cilin keni dhënë betimin.

Rifat Rustemi: Unë kisha dashur që të me sqaroni, pasi na e dimë, që më ligjin në fuqi dhe sipas ligjeve relative që ekzistojnë drejtën për thirrje e seancës ka kryetari i komunës, Kisha dashur një sqarim, lidhur me pozitën e zëvendësit e kryesuesit, pasi na veç e dimë situatën, që në seancën e

kaluar më 14 dhjetor keni thonë që presin sqarimin nga MAPL-ja, edhe pse ka ardhur sqarimi nuk është futur në rendin e ditës, ndoshta ka qenë gabim, pasi u hoq nga rendi i ditës, është në rregull në atë pjesë. Për këtë seancë kam fjalë, pse për këtë seancë nuk është futur në rendin e ditës zgjidhje e zëvendësit kryesuesit, dua një sqarim.

Predrag Grbic: Kurs është fjala për rendi e ditës, ato e përpilon kryesuesi i kuvendit në bashkëpunim me kryetarin e komunës. Është e vërteta që thash në seancën e kaluar, se ne presim një përgjigje nga MAPL-ja për zëvendësin e kryesuesit. Përgjigje që kemi marr nga Ministria ka arritur pak kohë, para së kemi dorëzuar material për këtë Kuvend. Në dokumentin i cilin ne kanë dorëzuar, janë dy propozime, njeri është që të arrijmë një marrëveshje politike, dhe dyta më qenë më short. Unë me qëllimin për një zgjedhje më të mirë, sepse është një funksion i cili do të këtë rëndësi e madhe, jo vetëm për funksionimin e Kuvendit, por për funksionimin e tërë komunës. Kam pritur që ata dy kandidat me numrin më të madh votave kontaktojnë me mua, dhe që së bashku të gjejmë një zgjidhje. A do të përdorim marrëveshje politike a do të përdorim short. Unë nuk e shoh ndonjë problem, nëse takohemi gjatë muajit shkurt dhe e bëjmë një marrëveshje e mirë, ku do të mbesin e kënaqur to dy palët, më sigurisht që nuk mund to dy më qenë zëvendësit e kryesuesit, por atë që e zgjidhim, e zgjidhim me marrëveshje e përbashkët dhe në këtë mënyrë do të krijojmë një Kuvend me cilën do të mburremi siç ka qenë deri tani. Kjo është vetmja arsye z, Rustemi, pse kjo pika sot nuk është në rendin e ditës.

Rifat Rustemi: Kryesuesi në rregull është, por, sa jam unë në denji ky interpretim i Ministrisë, e di që një here ka ardhur pa nënshkrim dhe pastaj ka ardhur në mënyrën e rregull, është protokolluar më 14.01, e mu në e-mall më ka ardhur më 17 janar. Seanca është thirrur pas kësaj datës edhe jam pak skeptik për këtë çështje, sepse vendimi ka ardhur më herët dhe ka mundur më u fut në rendin e ditës, pasi thirrja për kuvendin ka ardhur 2-3 ditë pasi ka ardhur kjo thirrja. Dhe mendoj që nuk ka qenë diçka pazgjidhshme, për mos më qenë në rendin e ditës, edhe sa i përket konsultimit kemi pasur kohë sepse seanca është thirrur dy ditë më vonë, kemi pasur kohën mjaftueshme dy ditë për më bërë konsultime, sepse mendoj që nuk nevojitet shorti, sepse kjo nuk është diçka e pazgjidhshme.

Predrag Grbic: Më siguri që nuk është i pazgjidhshme, ne vetëm kujdesemi që të zgjedhim më kujdes, pa asnjë problem. Tani kryetari më tha se do ta zgjidhim në shkurt, A lajmërohet edhe dikush për fjalë? Pasi nuk lajmërohet askush, e qes në votim rendin e ditës.

Konstatohet se me një zëri me 15 vota „për” e kemi aprovuar rendin e ditës.

2. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga seanca e kaluar e K.K Shtërpce

Predrag Grbic: A lajmërohet dikush për fjalë e lidhur me procesverbalin?

Konstatohet se me 15 vota “për” e kemi aprovuar procesverbal.

3. Zgjidhja e zëvendësit e kryetarit për komunitete

Predrag Grbic: Në faqen 37 të ligjit për vetëqeverisje lokale, në nenin 61. Lidhur më të gjitha që lidhet me zëvendësin e kryetarit e komunës për komunitete shkruan si në vijim: pika 61.1 thotë: në komuna ku së paku 10% qytetaret u përkasin komuniteteve pakica, ata do të kanë një zëvendës për komunitete, zëvendësi i kryetarit për komunitete emërohet e ka njëjtin mandat si

kryetari. Në pikën 61.3. thuhet: emërimi dhe shkarkimi e nënkryetarit për komunitete propozohet nga kryetari i komunës, dhe duhet të miratohet nga shumica këshilltareve, që janë prezent në sall, dhe të cilit votojnë dhe i përkasin komunitetit pakica. I nderuari kryetar, urdhëroni, propozoni kandidatin.

Bratislav Nikolic: Propozimi im për zëvendësin e kryetarit për komunitete është Fikri Hasani.

Predrag Grbic: Dëgjuam sugjerimin e z. Bratislav Nikolic. Fikri Hasani është kandidat për zëvendësin e kryetarit për komunitete. E qes këtë pik në votim, kush është që Fikri Hasani bëhet zëvendësi i kryetarit për komunitete

Konstatohet që më njëzë kemi aprovuar këtë pik e rendit të ditës.

3. Formimi i komitetit për politik dhe financa

Predrag Grbic: Pa marr parasysh që pika e ardhshme në rendin e ditës është formimi i Komitetit për Komunitete, unë menjëherë do të flas për to dy komitetet, që pastaj e kemi më të qartë. Në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, nenin 51, në faqen 32 thuhet: Kuvendi komunal formon dhe e mban takime të Komitetit për Politik dhe Financa si dhe Komitetit për Komunitete, si komitetet të përhershëm. Këto janë komitete të obliguar që në si Kuvendi duhet të kemi. Përveç atyre, gjatë vitit mundet të ketë edhe formimi e një komitet tjetër, nëse ka nevojë. Kur është fjala për Komitetin për Politik dhe Financa dhe Komitetin për Komunitete, ka pasur disa ndryshime. Na në përmbajtje të kaluar e Komiteteve kemi pasur ka 7 anëtarët, pra, kjo sipas statutit e komunës së Shtërpce, por, na në vitin e kaluar nga MAPL-ja kemi marr një udhëzim administrativ në të cilin thuhet: se numri i anëtarëve të komitetit përcaktohet në bazë të numrit e këshilltareve në Kuvend, tani ka 15 këshilltar. Arsye për këtë është numri i banorëve në komunën ton, ose të them më mirë mos përgjigja e shumicës serbe në regjistrimin e fundit popullsisë. Sipas rezultateve regjistrimit, në komunën ton jetojnë afër 7.000 banorë, dhe ne e përkasim kategorisë së komunave që kanë me pak si 10.000 banorë, dhe për këtë arsye ne kemi drejt që të kemi 15 këshilltar dhe kemi drejt për ka 5 këshilltar, në secilin komitet, të cila tani ne komplikon gjërat, sepse më të mirë dhe më të komotë e kishim në vetët kur komitete kanë numëruar 7 anëtarë. Ajo që ka rëndësi për Komitetin për Politik dhe Financa është që kryesuesi i Komitetit është gjithashtu kryesuesi i Kuvendit, që do më thotë, që tani duhet të zgjedhim edhe 4 anëtarë për këtë komitet. Ligji për Vetëqeverisje Lokale thekson se komiteti duhet të pasqyron përbërje e Kuvendit Komunal, dhe pasi ky kuvendi ka 11 anëtarët të Listës Serbe e komunitet serb dhe ne kemi 4 anëtarët të komunitetit shqiptar që vinë nga dy partia politike. Nëse ju nuk më llogaritni mua, dhe e llogariti atë dy e treta prej të gjithë, atëherë propozimi është, që për komiteti për politik dhe financa, Lista Serbe e propozon tri kandidat, a pjesa shqiptare e propozon një anëtar. Të komiteti për komunitete është më ndryshe, atë duhet të respektohen 3 rregulla. Rregulli i par, është që shumica e tyre janë përfaqësuesit të komuniteteve pakicë, e dyta që shumicën e përmban këshilltar, që kryesuesi i komitetit për komunitete, duhet më qenë nga komuniteti pakicë, në komunën ton jetojnë dhe komunitetit rom, ashtu që një vend i takon përfaqësuesit e komunitetit rom. Unë kisha propozuar, që kemi ka dy anëtarët nga komuniteti serb dhe shqiptar dhe një nga komuniteti Rom.

Rifat Rustemi: Kisha folur pak rreth përbërjes së Komitetit për Politik dhe Financa at udhëzimin që përmende ti më herët, Udhëzimi i Ministrisë e Pushtetit Lokal është obligativ dhe duhet të respektohet, përafërsisht që statuti është ndryshe, ndoshta do të ndryshojmë statutin në të ardhmen, por këto nuk mund të ndryshojmë përbërjen e komitetit. Kisha lexua nëse bon, një pjesë udhëzimit administrativ, së në bazë e kësaj përbërjes së kuvendit dhe në bazë të gjithë rrethanave në këtë kuvend. Përfaqësuesve shqiptar i takojnë dy vende dmt. Subjekteve politike i takojnë, to dy subjekteve i takon ka një ulëse në Komitet edhe unë nuk e shoh asnjë arsye për mos më qenë dy anëtar, njëri nga Iniciativa e Qytetareve edhe njëri nga PDK-ës, sepse ligji thotë ashtu, Komiteti për Politik dhe Financa përbëhet nga përfaqësuesit e subjekteve politike të cilat janë përfaqësuar në Kuvendin e Komunës. Përbërja e tij, duhet të reflektoj përfaqësimin i etniteteve politike si edhe numrin e ulësve nga etnitete politike e përfaqësuar në Kuvendin e Komunës, tjetra, nëse në përbërjen e Kuvendit e Komunës, janë përfaqësuesit e etniteteve politik, për çka është e pamundur përfshirje e të gjitha etniteteve në Komitetet për Politik dhe Financa, atëherë përfaqësimi i bëhet nga renditje e subjekteve politik, duke marr në konsiderim numrin e përfaqësuesve që janë përfaqësuar në Kuvendin e Komunës së Shtëpcës. Në këtu jemi tri subjektet politik në komunën e Shtëpcës, nëse kemi në 6 subjekte që kanë garuar në zgjedhje, atëherë nënkupton që një do të jetë pa përfaqësues në këtë Komitet, në rastin ton unë nuk e shoh arsyeshme me mbet një subjekt pa përfaqësuar në komitet për politik dhe financa.

Predrag Grbic: Unë jam këshilltar tashme në mandatin e tret z. Rustemi, dhe më kujtohet ajo përmbajtja, zgjedhje që ka qenë në vitin 2009, më duket që edhe ju atëherë keni qenë këshilltar. Kur u biseduar për komitetin për politik dhe financa, unë kam qenë i propozuar nga këshilltar, që të bëna këshilltar Komitetit për Politik dhe Financa, por, dikush nga një parti politike që e përket komunitetit shqiptar u ankuar, pasi jam votuar më kanë përjashtuar nga Komiteti për Politik dhe Financa. Në atë kohë, nuk u respektuar parimi që të gjitha parti politike janë të pranishme në atë Komitet. Dhe pse unë në zgjedhje kam fituar mjaft vota, dhe kam dhënë betimin, dhe sipas logjikës e juaj, edhe unë atëherë ka dashur që të jam anëtar i komitetit, por për keqardhje nuk isha. Në këtë rast kemi marr që ne kemi 3 përfaqësuesit nga komunitet serb, dhe 1 nga komuniteti shqiptar, nëse marrim parasysh tani dhe Komitetin për Komunitete, dhe numri i total është 10 anëtarët në to dy komitete, mos me llogarit mua dhe një anëtar e komunitetit rom, mbesin 8 kandidat, 5 do të janë komunitetit serb dhe 3 komunitetit shqiptar, që do më thonë që gati është gjysma.

Rifat Rustemi: Rasti i 2009, më kujtohet fare mire, atëherë kanë marr pjesë tri subjekte politike shqiptareve në zgjedhje, nëse nuk gabo, dhe tri subjekte serbe, do më thonë 6 subjekte, e di që jeni anashkaluar prej Komitetit për Politik dhe Financa, e di së përfaqësuesi edhe atëherë pa asnjë anëtar në komitet LDK-ës, janë bazuar që duhet më qenë i përfaqësuesit e LDK-ës, sepse ata kanë pasur dy përfaqësuesit në kuvend, ti kë qenë i vetmi kandidat prej një subjektit dhe për ata kanë reaguar atëherë, në at kohë, por atëherë ka qenë problemi, së ti vet je tërhequr, më vetë dëshirë ke tërhequr dorë prej kësaj punë, sepse nuk ke deshtë me bërë këtë punë më të madhe. Në at kohë nuk ka ekzistuar ky Udhëzim Administrativ i Ministrisë së Pushtetit Lokal, dmth. ky Udhëzim Administrativ është nga data 14.07.2014, tani jemi në një situatë tjetër, tani kanë garuar vetëm 3 subjektet politike, kjo është e mundur sepse edhe subjektet shqiptare janë barabar me vota, tani i cilit subjektit i takon, kjo nuk lejohet në asnjë rreth me asnjë ligj, ndoshta dikush ka frikën që në të ardhmen ne mundet të dominojmë për diçka, për një çështje në komitet, edhe kryesuesi llogaritet prej atij subjektit, ti je përfaqësuesi i Listës Serbe, je kryesuesi i Kuvendit dhe më automatizëm je i kryesuesi i Komitetit për Politik dhe Financa, ajo është sipas

ligjit, mirë ju jeni 3 përfaqësues, në jemi 2, nëse bëhet dhe nëse do të pretendojmë me kundërshtua diçka, nëse pretendohet që dëshirojmë më dominu na shqiptar, nuk di, nuk mundem me paragjykua edhe kështu jeni 3 më 2, nëse hymë edhe kryesuesi i ka votën e dyfishtë, për ata nuk e shoh asnjë arsye mos më pas na dy anëtarët, edhe në se ndoll kjo, unë personalisht këtë çështje do të ndjek, do të ankojem të organet relevante më tutje, nëse shqiptar mbesin më një përfaqësim në Komitet për Politik dhe Financa, sepse sipas të gjithave dispozitave, rrethanave në mundemi të përfaqësohem me dy anëtarët, situata është e kuart, unë nuk kuptoj pse nuk më pas përfaqësimin e subjekteve shqiptare.

Predrag Grbic: Ju keni qenë këshilltar edhe e dini kush e ka fjalën kryesor, fjalën kryesor e ka Kuvendi, a jo Komitetet. Komiteti për Politik dhe Financa është vetëm një organi që ndihmon në punën e Kuvendit, nëse diçka është aprovuar në Komitet për Politik dhe Financa, nuk do të thotë, që do të aprovohet edhe në Kuvend. Ne tani kemi dy propozime, kur ndoll diçka kështu atëherë shkojmë në votim dhe shumica vendos çka do të ndodhë. Ne kemi një propozim, i cilin e kam dhen unë, që Komiteti për Financa dhe Politik ka 5 anëtarët, dihet që unë jam Kryesuesi, Lista Serbe duhet të jep propozim për 3 kandidat, komunitet shqiptar duhet të jep emër për një kandidat. E qes në votim këtë propozim. Kush është për?

Konstatoj që më 11 vota për, një kundër edhe 3 abstenime e kemi aprovuar këtë propozim.

Unë kisha filluar me propozimet, për emrat, për Komitetin për Politik dhe Financa. Unë nga komuniteti Shqiptar, kam marr një propozim më shkrim që anëtare Komitetit për Politik dhe Financa është z. Blerta Hazizi

Dragomir Stanisavljevic: Unë propozoj Anen Milosavljevic

Ana Milosavljevic: Unë propozoj Miroslavin Djordjevic

Predrag Grbic: Unë kisha propozuar Dragomirin Stanisavljevic

Propozimi për anëtarët e Komitetit për Politik dhe Financa është: Predrag Grbic, dmth, unë si kryesuesi, përsëri po ju them, që kjo është parapa më ligj, Dragomir Stanisavljevic, Miroslav Djordjevic, Ana Milosavljevic dhe Blerta Hazizi.

E qes në votim këtë propozim. Kush është për?

Konstatoj që me 14 vota për kemi aprovuar këtë propozim, 1 këshilltar nuk ka votuar.

Rifat Rustemi: Kryesues vetëm që ju paralajmëroj, që me rastin e formimit Komitetit për Politik dhe Financa keni bërë shkelje ligjore, është normale që demokracia është ajo që vendos shumica, në mundemi këtu në Kuvend si shumica absolute më marr një vendim e cili është në kundërshtim më ligjin dhe munden me e shfuqizua. Ashtu që në të ardhmen mund të shfuqizohet ky vendim, sepse nuk është formuar në mënyrë ligjore. Pak po më befason edhe drejtori i administratës, nuk e dha asnjë mendim, ndoshta ka mundur me ndihmuar në këtë drejtim.

Predrag Grbic: Çdo vendim, të cilat e merr Kuvendi, në afat prej 7 ditëve, dërgohet në MAPL në interpretim, atje ekziston një komision i cili e interpreton ligjshmërinë ose vlefshmërinë e vendimeve të marra. Nëse vendimi nuk është në përputhje me ligjin, në afatin prej 15 ditëve marrim përgjigje nga Ministria, dhe jemi detyruar, nëse kjo pika është në kundërshtim më ligjin, të përsëri e vendosim në shqyrtim.

Havzi Ahneti: Themelimi i komiteteve të përhershëm janë në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, janë dy Komitete të përhershëm, Komiteti për Politik dhe Financa edhe Komiteti për komunitete, të cilat e zgjedh kuvendi, në këtë rast Komiteti për Politik dhe Financa nuk është e përcaktuar, ashtu që edhe vet e keni potencuar dhe lexuar udhëzimin administrativ, që çdo subjekt politik duhet të jetë i përfaqësuar në komitetet e caktuar. Unë dëgjova me vëmendjen, edhe kur keni cituar dispozitat e udhëzimit administrativ, edhe pikërisht ashtu është, po askund në ato dispozita në të cilat jeni thirrur, nuk është prapomë edhe nuk është përshkruar, që të gjitha subjekte politike e përfaqësuar në asambleje komunale, do duhet të ishin anëtarët e një Komitetit të caktuar. Komiteti për Politik dhe Financa e përfaqëson entitete politike në një Kuvend, duke marr për bazë përbërjen e atyre entiteteve politike, ato reflektojnë fuqi e entitetit politik brenda një kuvendit të caktuar. Në këtë rast ne kemi pasur dilema më herët, kur janë zgjedhur komitete, kemi mundur më përfaqësua më më shumë subjektet politike, për at që kemi pasur një numër më të madh e anëtareve. Unë nuk jam këtu për më interpretimin e marrëveshjeve politike të cilat e bëjnë subjektet politik për zgjedhje e Komitetit për Politik dhe Financa dhe çdo Komitetit tjetër, asnjë organ tjetër. Unë jomë këtu për më interpretimin dispozitat ligjore, por më gjitha atë dispozitat përfundimtare interpretimin e bon Zyra Ligjore e Ministrisë së Pushtetit Lokal, kështu që çdo vendim i Kuvendit të Komunës i nënshtrohet një mbikëqyrje të legjislacionit e çdo aktit e cilën e nxër një Kuvendi i Komunës, më të cilën njoftohemi më shkrim, lidhur me mirëmbajtjen e gjithë procesit, edhe në fund jepet opinioni ligjor për çdo vendim që e nxër Kuvendi i Komunës. Edhe kështu që neve na mbetet që të presim interpretimin ligjor e këtij themelimit e Komitetit edhe çdo organit tjetër, ashtu si kemi veprua deri më tani

Predrag Grbic: Duhet ta cekim, që jemi tu e respektuar barazinë gjinore, dhe këtu kemi dy zonjat në Komitet për Politik dhe Financa

4. Formimi i komitetit për komunitete

Predrag Grbic: Ajo që duhet të respektohet të ky komiteti është së shumica e tyre janë këshilltar, shumica prej tyre janë përfaqësuesit e komunitetit pakicë dhe që kryesuesi është nga një komunitet pakicë. Propozimi është që do të kemi 2 përfaqësuesit të komunitet shqiptar, 2 komunitet serb dhe një përfaqësuesi komunitetit rom. Pasi askush nuk lajmërohet për fjalë, dua të përmendi së kam marrë dy emra nga përfaqësuesit e komunitetit shqiptar për anëtarët e Komitetit për Komunitete. Njëri është z. Garip Sahiti, i cili vjen nga PDK, dhe dyta është Hirije Imeri, ajo vjen nga Nisma e Qytetareve. Unë e propozoj nga komuniteti rom Muhamet Eminin Miroslav Djordjevic: Unë e propozoj Radojka Repinovic Sonja Kuzmanovic: Unë propozoj Srdjana Kostic

Predrag Grbic: Qes në votim këtë propozim, pasi kemi 5 emra, kush është për? Konstatoj që kemi komitetin për komunitet në këtë përbërjen: z. Garip Sahiti. Hirije Imeri, Radojka Repinovic, Srdjan Kostic dhe Muhamet Emini.

Tani duhet të zgjedhim kryesuesin e Komitetit për Komunitete, prandaj e luti përfaqësuesit e komunitetit shqiptar, që të japin propozim për kryesuesin e Komitetit për Komunitete

Garip Sahiti: Mendoj që ma mirë është me lëmi ato për të zgjedhur në takimin e Komitetit

Predrag Grbic: Në rregull, e pranoj propozimin e juaj.

Rifat Rustemi: Unë, vetëm diçka nuk mundem të kuptoj, ti si kryesuesi a e përfaqëson të gjitha subjekte në kuvend, dmth. Për komitetin për politik dhe financa ka qenë propozimi i dikujt nga

përfaqësuesve e një partie, prapë për komitet për komitete e propozove emrat, a je përfaqësuesi i PDK-ës, nuk di, a përfaqëson të gjitha subjekte këto. Nuk e kam qartë.

Predrag Grbic: Unë kam marr në fillim propozim nga përfaqësuesit e komunitetit shqiptar, para Kuvendit, që është e drejta e tyre. Ata më kanë dhënë propozime më shkruar, që nuk do të thotë së nuk mund të këtë propozime të tjetër. Këto kanë qenë propozime e tyre dhe secili ka të drejtën një propozim tjetër. Nuk pashë që dikush tjetër ngriti dorën dhe ka dhënë një propozim tjetër, prandaj në pajtimin me propozimet, të cilat e kam marr, kam vepruar gjatë zgjedhjes dhe formimit e Komitetit.

Rifat Rustemi: A ka mundësi kryesues, më dit ku e ke marrë emrat për anëtarin e Iniciative e Qytetareve, sepse unë jam i përfaqësuesi i asaj partisë, sepse unë nuk di asgjë, edhe dua ta di kush ju ka dhënë emrin për anëtarin e Iniciative, sepse unë kam qenë bartësi i listës, dhe nuk e kuptoj kush ta ka dhen at emrat, dua ta di

Predrag Grbic: Unë kam marr me shkrimin propozimin e emrave, duke pasur parasysh se ju keni ra në dakord midis juve. Ju keni pasur të drejtën për të lajmëruar për fjalën, dhe të paraqitni propozimin e tuaj. Jo vetëm ju, të secili këshilltar e pranishëm këtu mund të thotë ato që mendon, dhe të japin propozimin e tij, që Kuvendi në mënyrë demokratike i zgjedh dhe vendos çka do të kalon.

5. Formimi i komisionit për hartimin e planit të punës së Kuvendit

Predrag Grbic: Ajo që është më e rëndësishme në këtë planë punës është që të janë gjerat të cilat janë e obligueshme më ligj, që të gjenden në muajin e caktuar. Në atë komision, përveç këshilltarëve, janë edhe drejtoret të gjithë drejtorive, ashtu që unë propozoj që në këtë komision janë 2 përfaqësuesit e komunitetit shqiptar, 2 komunitetit serb, unë si kryesuesi, që atë është edhe sekretari i kuvendit Staja Markovic:

Vesna Markovic: Unë propozoj Miroslavin Djordjevic

Predrag Grbic: Unë propozoj Srdjanin Krstic

Garip Sahiti Unë propozoj Rifat Rustemija

Rifat Rustemi: Unë propozoj Garip Sahiti

Predrag Gbic: E qesë në votim këtë propozim kush është për?

Konstatohet që më njëzë e kemi aprovuar këtë propozim për formimin e komisionit për hartimin e planit të punës së Kuvendit.

6. Propozim i vendimit për hartimin e planit zhvillimor e komunës

Dimitrije Racicevic: Komuna e Shtërpçës në vitin 2012, ka hartuar një plan zhvillimit të komunës së Shtërpçës, dhe në muaj dhjetor është miratuar nga Kuvendi, më të gjitha procedurat ligjore, të cilat janë respektuar dhe më lejen e Ministrisë për Planifikim Hapësinor. Në bazë të Udhëzimit Administrativ e atëherëshëm, pas 5 vitesh, ka dashur të bëhet auditivi të këtij planit

zhvillimor , dhe kjo ka dashur të bëhet në fund të vitit të kaluar ose në fillim të këtij viti. Por, gjatë vitit e kaluar, Ministria e Planifikimit Hapësinor ka lëshuar një ligj të ri, i cili është në fuqi nga muaj korrik, dhe në bazë të atij ligjit dhe Udhëzimit të ri Administrativ, të gjitha komuna kanë obligim për të bërë një plan të ri zhvillimor, për komunën e tyre. Për këtë qëllim, dhe për të qenë në përputhje me procedurat ligjore, nevojitet që kjo pika të votohet nga këshilltaret, për të filluar të gjitha procedurat e tjera ligjore. Pastaj ajo shkon në zyrën e prokurimit , shpallet tenderi për kontraktimin e një kompanie këshilluese, të cila do të na ndihmon për përgatitje të këtij plani ligjor. I gjithë ky procesi zgjat rreth 6 muaj dhe do të përfshihen të gjitha drejtoritë e komunës së tonë, përfaqësuesit e bizneseve, bujqësisë dhe të gjithave dega e tjera veprimi ekonomik.

Predrag Grbic: A lajmërohet dikush për fjalë? Pasi nuk lajmërohet askush, unë do të qes këtë pikë në votim.

Konstatohet që më njëzë e kemi aprovuar këtë pikë e rendit të ditës

7. Të ndryshme

Predrag Grbic: Kisha propozuar z. Garipit dhe z. Rustemit që në muajin e ardhshëm takohemi, dhe të bëjmë një marrëveshje sa më të mirë të mundshme në lidhje me zgjedhje të zëvendësimit të kryesuesit. Unë jam në dispozicionin tuaj, për të gjetur një mënyrë ku nuk do të ketë dyshim dhe asnjë konfuzion. Ajo që keni gjetur para jush, AKK ka shpërndarë ftesa për një seminar, kjo kryesisht është për këshilltaret e ri. Është organizuar për 1 shkurt në Gjilan. Kisha lus që ata këshilltar të cilit do të shkojnë, të cilit mendojnë që kjo do të jetë e dobishme për punën e tyre , që të ne lajmërohen deri në mërkurën, që ne mund të sigurojmë veturat për shkuarjen e tyre. Ata mundën të lajmërohen në zyrën e sekretarit të Kuvendit.

Garip Sahiti: Kam deshtë me lidhur më këtë festë, që ka ardhur nga Asociacioni i Komunave të Kosovës, sa di unë, janë mbajtur dy seancat, dhe besoj që ju kanë ardhur me vanës ftesat, pasi dy takime janë mbajtur deri me tani, pasi ky është takimi i tret i Asociacionit të Komunave të Kosovës, është mirë së ardhur, vetëm ne këshilltar të ri kemi humbur dy seancat të para, që besoj që do të marrim material atje, unë personalisht në këtë seminar nuk mundem me marr pjesëmarrje për shkak se disa angazhimeve të mia e tjerë not e japin mendimin secili.

Predrag Grbic: Shpesh kemi probleme me internetin. Ka ndodhur që më ditë nuk ka funksionuar, dhe komuna është në bllokadë.

Rifat Rustemi: Kam një dy- tri çështje shumë të shkurta. Lidhur me pastrimin, rrethimin dhe rregullimin e varrezave në f. Brod, po foli një herë konkretisht për f. Brod , e di se para disa vite komuniteti i ka mbledhur para për mirëmbajtjen edhe rrethimin e atyre varrezave, mirë, por ata kanë thënë që ato para e kanë dhënë komunës edhe komuna ka thënë, kur do të ketë mjete do të shton. Nuk jam tu fol vetëm për varrezat në f. Brod jam tu fol për gjitha varrezat, duhet më gjet një zgjidhje për me mirëmbajtje varrezat në përgjithësi. E dyta, mirëmbajtja e faqes së komunës, nuk po them që nuk është funksionale, por nuk ka njoftime për seancat e kuvendit, as pikat e rendit të ditës, njoftimi i fundit ka qenë para tre muaj, nëse nuk po gaboje, në faqen e komunës. Edhe mos jam krejt kritik, e kam edhe një lavdërim, sa i përket mirëmbajtjes së rrugës edhe sepse u kanë dimri shumë e but sivjet, mirë po rrugët janë mirëmbajtur mirë në tërësi , në

përrjashtim në lagjen Emerlahut për të shkollës në f.Brod edhe në f. Jazhince ka pas pak telashe, ka përmirësim në këtë drejtim

Predrag Grbic: E falënderoj g.Rustemi për lavdërim që kemi marr prej jush, ajo na bën të luntur, deri tani ju vetëm na keni kritikuar.

Sinisa Buduric: Drejtoria në planin i punës për muaj prill ka mirëmbajtjen të gjithë varrezave në territorin e komunës së Shtërpçës, varrezat e serbe dhe varrezat e shqiptareve.

Laza Arsic: Kush në javën ka mundur e kaluar me vizituar ueb-faqen ton, ka pa që punohen ueb- faqet të reja nga MAPL-a. Të gjitha ueb-faqe në Kosovë janë të skuqur dhe edhe ueb-faqja e Shtërpçës. Aktualisht është në përpunimin ueb-faqja e re, kur fillon me funksion në të gjitha komuna në Kosovë, do të lëshohet në punim edhe faqja e komunës së tonë.

Predrag Grbic: A lajmërohet dikush për fjalë? Pasi nuk lajmërohet askush, seanca e par e rregull e sotshme ka përfunduar, falënderoj të gjithë në pjesëmarrje.

Procesmbajtësi
Staja Markovic



Kryesuesi i K.K.
Predrag Grbic
